



## PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË

Departamentit për Krime të Rënda

Në mbështetje të Nenit 79, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 80, paragrafi 1, të Kodit nr. 04/1-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Teutë Rrusta, në cilësi të Sekretares së Përgjithshme të Partisë Social Demokrate, me datën 23 shtator 2021, parashtron këtë:

### KALLËZIM PENAL

Kundër Arben Vitisë, Ministër pranë Ministrisë së Shëndetësisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkak të kryerjes së veprave penale në kuadër të Kapitullit XXII të veprës penale kundër shëndetit publik *Përhapja e sëmundjeve ngjitëse*, e përcaktuar sipas Nenit 249 si dhe në kundër të Kapitullit XXXIII të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare, përkatësisht veprën *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*, të përcaktuar sipas Nenit 414 e të gjitha sipas Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës Së Kosovës

### s e p s e

Në nëntor të vitit 2019 një sëmundje e panjohur më parë dhe e emëruar më vonë si COVID-19 dhe e shkaktuar nga virusi SARS-CoV2 shpërtheu në Vuhan të Kinës, për tu përhapur më tutje në të gjithë botën, duke u shpallur pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë më 11 mars 2020 e duke u trajtuar si e tillë edhe sot e kësaj dite.

Rasti i parë i COVID-19 në Republikën e Kosovës u identifikua më 13 mars 2020. Përgjatë ditëve dhe javëve në vijim rastet e sëmundjes u konfirmuan në të gjitha komunat e vendit. Duke pasur parasysh faktin se bëhej fjalë për një virus të panjohur më parë dhe për të cilin nuk kishte mjekim efektiv apo vaksinë, që nga fillimi i pandemisë organizatat ndërkombëtare, rajonale dhe nacionale të shëndetësisë sugjerorin masa që synonin kontrollimin e shpërthimeve të sëmundjes si formë e vetme të ballafaqimit me pandeminë. Këto masa konsistojnë kryesisht në testime për sëmundjen, ndërprerje apo ngadalësim të përhapjes sëmundjes dhe zbutje të efekteve të sëmundjes në sistemin shëndetësor dhe shoqëri. Sikurse nëpër vende të ndryshme të botës forma të ndryshme të këtyre masave filluan të zbatoheshin edhe në Kosovë, pas konfirmimit të rastit të parë me COVID-19. Masa të tilla ishin dhe vazhdojnë të jenë kufizimet e lëvizjes, kufizimet e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, kulturore e sportive, mbyllja e institucioneve arsimore, mbajtja e distancës fizike, mbajtja e maskave e të tjera. Përgjatë pandemisë, aplikimi i këtyre masave në Republikën e Kosovës dhe



nëpër botë ka evoluar për shkak të njohurive të fituara për natyrën e shkaktarit dhe sëmundjes. Përveç kësaj, shtrëngimi apo lehtësimi i këtyre masave ka ndryshuar në vazhdimësi varësisht prej situatës epidemiologjike dhe ngarkesës së sistemit shëndetësor. Në këtë drejtim për nevojat e krijimit të një legjislacioni adekuat për t'u përballur më lehtë me pasojat e kësaj situatë epidemiologjike është dekretuar me datën 20 gusht 2020 Ligji nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës i miratuar me 14 gusht 2020 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në dhjetor të vitit 2020 ndodhi aprovimi i vaksinave të para dhe filloi aplikimi i tyre në shumë vende të botës. Në Kosovë procesi i vaksinimit filloi më 29 mars 2021 dhe po vazhdon edhe sot. Si përgjigje ndaj përkeqësimit të situatës epidemiologjike përgjatë këtyre 18 muajve të pandemisë në Kosovë, Qeveria e Kosovës në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik ka aplikuar masa për kontrollimin e shpërndarjes së sëmundjes.

Vlerësimi i situatës epidemiologjike dhe nevojës për shtrëngim apo lehtësim të masave kufizuese bëhet në bazë të disa indikatorëve epidemiologjik ku ndër më të rëndësishmit janë rastet ditore të të infektuarve me COVID-19, numri i rasteve aktive me COVID-19, numri i të hospitalizuarve dhe rastet ditore të vdekjeve. Natyrisht, në një situatë relativisht të qetë epidemiologjike, rritja e rasteve ditore të të infektuarve shërben si indikator i parë që paralajmëron një përkeqësim të situatës dhe rritje të vlerave të indikatorëve të tjerë të përmendur më lart. Në këtë drejtim, nga praktika botërore dhe ajo në vend është e qartë që dy faktorë janë vendimtarë në efikasitetin e masave kufizuese në ndërprerjen e përhapjes së sëmundjes në rast të rritjes së rasteve, shpejtësia e ndërmarrjes së tyre dhe ashpërsia e tyre.

Që nga pjesa e dytë e muajit maj e deri rreth datës 22 korrik 2021 situata epidemiologjike e COVID-19 në Kosovë paraqitet e qetë, duke pasur shkallë të pozitivitetit nën 1%. Gjatë kësaj periudhe, përkatësisht në muajin maj, qershor dhe korrik të këtij viti, Qeveria e Republikës së Kosovës merr tri vendime të reja për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19

**Provë:** *Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, i datës 28 maj 2021, me nr. të protokollit 04/14; Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, i datës 22 qershor 2021, me nr. të protokollit 14/16; dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, i datës 14 korrik 2021, me nr. të protokollit 19/19.*

Në këto tri këto vendime kemi një vazhdimësi të lirimit të masave të kontrollit duke u përmblytur me vendimin e datës 14 korrik 2021 përmes të cilit krijohet një situatë ku pothuajse ka lirim të plotë të këtyre masave, me lejimin e aktiviteteve që në epidemiologji konsiderohen me potencial të madh shpërndarës, siç janë lejimi i punës së klubeve të natës, ahengjeve dhe dasmave deri në ora 01:00, dhe shërbimet e gastronomisë deri në ora 23:00, me zgjatje të orarit të premtëve dhe të shtuneve deri



në ora 00:00. Të gjitha këto vendime të Qeverisë në arsyetimin e tyre i referohen të dhënave aktuale mbi situatën epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShpK-së.

Duke iu referuar raporteve ditore të publikuara nga IKShPK-ja është e qartë që rreth datës 22 korrik 2021 në Kosovë fillon një rritje eksponenciale e rasteve ditore të të infektuarve me COVID-19, pra dyfishim të rasteve në një periudhë prej rreth 5-6 ditëve, që përputhet me të ashtuquajturin intervalin serik të përhapjes së COVID-19 apo kohës nga infektimi të një personi deri te paraqitja e simptomave. Nga 5 raste pozitive më 21 korrik 2021, me datën 12 gusht 2021 numri i rasteve pozitive arrin në 1006. Në të njëjtën periudhë, numri i rasteve aktive nga 114 arrin në 4414, numri i hospitalizimeve në qendrat e kujdesit intensiv nga 94 në 214.

**Provë:** *Renditja tabelare e rritjes së rasteve sipas të dhënave të publikuara nga IKShPK-ja e titulluar si Tabela 1 dhe Grafika 1.*

Është e rëndësishme të theksohet se në të njëjtën periudhë nuk ka rritje eksponenciale të numrit të hospitalizimeve dhe të vdekjeve për shkak se arsyeja qëndron tek një fakt i mirënjohur për të gjithë profesionistët e epidemiologjisë e që njihet si vonesë e hospitalizimeve në qendra të kujdesit intensiv pas shfaqjes së simptomave që sipas Zyrës Nacionale për Statistika të Britanisë së Madhe janë 6 - 10,5 ditë, por edhe si dhe vonesë e vdekjeve pas hospitalizimit në qendra të kujdesit intensiv që sipas Zyrës Nacionale për Statistika të Britanisë së Madhe janë 7 - 12,5 ditë.

**Provë:** *Për nevojat e vërtetimit të pretendimeve të mësipërme të këtij kallëzimi penal, të njëjtit i bashkëngjitet në formën dhe përmbajtjen e vet origjinale një raport i Zyrës Kombëtare të Statistikave të Britanisë së Madhe lidhur me këto çështje i titulluar "Coronavirus (COVID-19) Infection Survey technical article: eaves and lags of COVID-19 in England, June 2021".*

Shpërthimi i epidemisë i përshkruar më lartë, sipas raporteve ditore të IKShpK-së paraqet shpërthimin me intensitetin më të lartë përgjatë 18 muajve të epidemisë së COVID-19 në Kosovë. Arsyet për një intensitet të tillë besohet të jenë të shumta duke përfshirë e duke mos u kufizuar në numrin e vogël të qytetarëve të imunizuar me vaksina, ku më 22 korrik 2021 kishim 99.377 persona të vaksinuar me dozën e dytë, lirimim në masë të madhe të masave të kontrollit sipas tri vendimeve të lartcekura, numrin e madh të mërgimtarëve në Kosovë në periudhën në fjalë, si dhe vet praninë e variantit Delta të virusit COVID-19.

Duhet thënë se në lidhje me variantin Delta dhe rreziqet që ai paraqiste institucionet dhe opinionin publik në Kosovë kishin tashmë të dhëna të mjaftueshme. Ajo që nga hulumtimet e ndryshme tashmë ishte e sigurt në muajin qershor është se varianti Delta i SARS-CoV-2 është të paktën 100% më i transmetueshëm ose kontagioz sesa varianti fillestar i virusit dhe se shkalla e hospitalizimeve nga ky variant ishte me gjasë gjithashtu më e lartë.

**Provë:** *Për nevojat e vërtetimit të pretendimeve të mësipërme të këtij kallëzimi penal, të njëjtit i bashkëngjitet në formën dhe përmbajtjen e vet origjinale katër dokumente nga Kolegji Imperial i Lonrës, Grupi Shkencor Këshillues për Emergjencë pranë Qeverisë Britanike, dhe Shërbimi Publik i Skocisë.*



Në Kosovë varianti Delta u identifikua në 2 nga 22 mostra të dërguara për analizë në Klinikën Universitare Charite në Berlin, sipas një njoftimi të Ministrisë së Shëndetësisë me datën 29 qershor 2021. Tutje me datën 23 korrik 2021 OBSH-ja raportonte që varianti Delta ishte varianti dominues në rajonin e Evropës ndërsa më datën 30 korrik 2021 IKShPK-ja njoftoi që nga analizat e fundit 80-90% të rasteve në Kosovë po shkaktoheshin nga varianti Delta.

Më datën 12 gusht 2021 Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë miraton masa të reja për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Në arsyetimin e këtyre masave ndër të tjera thuhet se *“duke ju referuar të dhënave aktuale mbi situatën epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShPK - së, Qeveria ka balancuar interesin e ruajtjes së shëndetit publik dhe interesit ekonomik, duke marrë masa të cilat në njërin anë mundësojnë një aktivitet të shtuar ekonomik, ndërsa në anën tjetër kontrollojnë dhe parandalojnë shpërndarjen e COVID19”* dhe *“Qeveria ka ndërmarrë masat kufizuese të lartpërmendura, me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së COVID-19, në aktivitetet dhe bizneset të cilat mund të jenë supershpërndarës të infeksionit”*.

Në vendimin e datës 12 gusht 2021 ajo që është lehtë e identifikueshme është se shumica e masave mbesin të pandryshuara dhe për më tepër kemi lirim të masave për dy lloj aktivitetesh, për 8 ditë e ardhshme pasi për nga data 20 gusht 2021 me të njëjtin vendim parashiheshin masa tjera ku fjala është për gastronominë, ku kemi zgjatje të orarit nga ora 23:00 gjatë ditëve të punës dhe ora 00:00 për të premtet dhe të shtunet, në orën 00:00 për të gjithë javën dhe klubet e natës, ku orari nga ora 01:00 zgjatet në orën 03:00. Pra bëhet fjalë për dy aktivitete që dihet që shërbejnë si shpërndarëse të infeksionit COVID-19 e ku të paktën klubet e natës botërisht konsiderohen si biznese apo aktivitete tej shpërndarëse të këtij virusi. Vlen të përmendet edhe fakti që aktivitete tjera shpërndarëse të virusit siç janë dasmat, ahengjet e fejesat, me vendimin e lartpërmendur lejohen të vazhdojnë të mbahen në orar të pandryshuar pra deri në ora 01:00.

**Provë:** *Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, i datës 12 gusht 2021, nr. i protokollit 01/25.*

Ajo që është e qartë është se masat e vendosura më 12 gusht 2021 janë në shpërputhje të qartë me situatën epidemiologjike që Kosova po kalonte në periudhën përkatëse e cila u sqarua më lartë dhe gjithashtu në shpërputhje me arsyetimin e këtyre masave ku thuhet se këto masa *“kontrollojnë dhe parandalojnë shpërndarjen e COVID19”* dhe se *“Qeveria ka ndërmarrë masat kufizuese të lartpërmendura, me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së COVID-19, në aktivitetet dhe bizneset të cilat mund të jenë supershpërndarës të infeksionit”*. Përveç kësaj, duke iu referuar deklaratave të Ministrit të Shëndetësisë, z. Vitia në intervistën e tij dhënë në emisionin #KallxoPernime të gazetares znj. Jeta Xhara, i realizuar me datën 15 shtator 2021, vendimi i datës 12.08.2021 ishte në kundërshtim me rekomandimet e IKShPK-së e ku i njëjti e pranon se rekomandimi i IKShPK-së ishte kufizimi i disa aktiviteteve ekonomike dhe jo lirimi i ndonjë mase siç edhe ishte paraparë me 12 gusht 2021.



**Provë:** *Emisioni #KallxoPernime i gazetares znj. Jeta Xhara, i realizuar me datën 15 shtator 2021, i cili mund të gjendet në platformën YouTube sipas titullit si në vijim: Emisioni #KallxoPernime - Intervistë: Arben Vitia - 15.09.2021.*

Së këndejmi është e rëndësishme që në mënyrë të përmbledhur të përshkruhet situata epidemiologjike në Kosovë pas marrjes së këtyre masave, përkatësisht atyre me datën 12 gusht 2021 si dhe kauzaliteti i qartë ndërmjet masave në fjalë dhe përshkallëzimit të shpërthimit të epidemisë dhe pasojave tragjike të tij.

**Provë:** *Renditja tabelare e rritjes së rasteve sipas të dhënave të publikuara nga IKShPK-ja e titulluar si Tabela 2 dhe Grafika 2.*

Më 19 gusht 2021, pra 7 ditë pas masave të reja, kemi më shumë se dyfishim të rasteve ditore me të infektuar me COVID-19 (nga 1006 persona në 2236 persona), numri i rasteve aktive nga 4414 persona arrin në 14.249 persona, dhe hospitalizimet nga 214 persona arrijnë në 626 persona. Situata vazhdoi të rëndohej më tutje pas datës 19 gusht 2021 në aspektin e hospitalizimeve dhe vdekjeve.

Të dhënat nga data 19 gusht 2021 e tutje shërbejnë si një tregues i mirë i efektit negativ të vonesës në marrjen e masave kufizuese me kohe dhe sidomos vendimit për masa të reja të datës 12 gusht 2021. Ajo që duket qartë është se masat në vendimin e lartpërmendur jo vetëm që nuk arritën të kontrollojnë dhe prandalojnë shpërndarjen e COVID-19, përkundrazi, të njëjtat lejuan më shumë se dyfishimin e rasteve ditore dhe trefishimin e rasteve aktive pas 8 ditëve, duke prodhuar kështu një shpërthim epidemik tragjik.

Nga të dhënat e prezantuara në raportet ditore të IKShPK-së, duke përlogaritur intervalin serik të përhapjes së COVID-19 dhe vonesën e vdekjeve, është lehtë të konkludohet që dështimi për të ndërmarrë një vendim efikas në datën kritike, 12.08.2021, u ka kushtuar me jetë qindra qytetarëve të Republikës së Kosovës.

**Provë:** *Renditja tabelare e rritjes së rasteve sipas të dhënave të publikuara nga IKShPK-ja e titulluar si Tabela 3 dhe Grafika 2.*

Dëmi i shkaktuar nga ky shpërthim epidemik shkon përtej jetëve të humbura. Një numër i konsiderueshëm i të infektuarve nga COVID-19 që sipas OBSH vlerësohet të jetë rreth 10% zhvillojnë formën kronike të sëmundjes, të njohur si Long COVID, me një ndikim domethënës në mirëqenien e tyre, në shoqëri e sistem shëndetësor.

**Provë:** *Për nevojat e vërtetimit të pretendimeve të mësipërme të këtij kallëzimi penal, të njëjtit i bashkangjitet në formën dhe përmbajtjen e vet origjinale një raport i OBSH-së i titulluar si në vijim: In the Wake of the pandemic - Preparing for Long COVID.*

Përveç kësaj, për shkak të këtij shpërthimi epidemik dhe mbingarkesës së prodhuar në sistemin shëndetësor, shërbime tjera shëndetësore janë pamundësuar në klinikat specialitike të QKUK-së. Përtej efekteve të drejtpërdrejta shëndetësore e sociale të këtij shpërthimi, dëmi i shkaktuar merr



edhe dimension të rëndësishëm ekonomik si pasojë e masave drastike kufizuese që aplikohen nga data 20 gusht 2021 e që vazhdojnë ende, si dhe gjobave të shumta të shqiptuara si pasojë e tyre. Shumë prej këtyre masave dhe barrës së shkaktuar prej tyre do të ishin të evitueshme sikur të merrej një vendim i duhur më 12. gusht 2020.

Përbrenda kontekstit kronologjik të ngjarjeve të përshkuara më sipër elementet kyçe të veprave penale të përshkuara në këtë kallëzim penal qëndrojnë në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, të datës 12 gusht 2021, i cili vendim qartazi krijon rrethanën kryesore në shërbim të krijimit të pasojave të rënda epidemiologjike ku shumë prej tyre shkaktuan edhe vdekjen e qindra qytetarëve të Republikës së Kosovës. Një element i rëndësishëm i mungon këtij vendimi - përputhja e tij me rekomandimet e IKShPK-së, të cilat ndonëse nuk janë bërë publike, të njëjtat sipas deklaratave të vet z. Viti ka qenë të ndryshme prej masave të marra me 12 gusht 2021 përmes atij vendimi. Që nga paraqitja e kësaj pandemie, vendimet qeveritare i janë referuar rekomandimeve të IKShPK-së. Kjo në fakt nuk është që ka qenë vetëm një praktikë logjike e ndërtuar ku një institucion politik sikurse Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e saj e Shëndetësisë lidhur me një çështje epidemiologjike vendimet i bazon mbi të gjeturat shkencore të një institucioni publik shkencor sikurse siç është rasti me IKShPK-në, i cili institucion përbën instancën më të lartë publike e shkencore për nga rëndësia lidhur me çështjet e shëndetit publik në vend, por në fakt vendimmarrja e Ministrit të Shëndetësisë, përkatësisht përputhja e saj me rekomandimet e IKShPK-së obligon këtë të fundit gjithnjë sipas asaj që është paraparë decidivisht me Ligjin nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, i cili ligj për nga fusha e tij e veprimit në Nenin 2, Paragrafi 1 *përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve shtetërore, institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësive gjatë pandemisë COVID-19, si dhe sipas Paragrafit 2 përcakton masat dhe sanksionet të cilat do të ndërmerren ndaj personave fizik dhe juridik, shtetas të Republikës së Kosovës apo të huaj me qëndrim në Republikën e Kosovës, të cilët i shkelin rregullat, vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga organet kompetente, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit, pandemisë të shkaktuar nga COVID-19, rrjedhimisht kjo fushë e veprimit e këtij ligji, të njëjtin e bën krejtësisht të zbatueshëm karshi vendimmarrjes së datës 12 gusht 2021.*

Së këndejmi, Neni 10, Paragrafi 6 i këtij ligji precizon se *sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe IKSHPK-së, Ministria e Shëndetësisë publikon masat mbrojtëse të detyrueshme për persona dhe institucione. Vendimi për masat mbrojtëse duhet të përfshijë edhe sqarimin se mos zbatimi i cilave masa mbrojtëse është kundërvajtje ligjore apo vepër penale.* Tutje, Neni 12, Paragrafi 4, precizon se *për të mbrojtur popullatën nga COVID-19, Ministri i Shëndetësisë, në përputhje me rekomandimet e IKSHPK-së, OBSH-së, miraton masa të veçanta për mbrojtje nga COVID-19, e të cilat masa përbëjnë 1. kufizimin ose ndalimin e udhëtimeve në vendin ku është përhapur pandemia COVID-19; 2. kufizimin ose ndalimin e qarkullimit në rajonet e infektuara ose të rrezikuara; 3. kufizimin ose ndalimin e qarkullimit të llojeve të ndryshme të mallrave dhe produkteve; 4. marrjen pjesë, në mënyrë të*



*detyrueshme, të institucioneve shëndetësore dhe institucioneve të tjera, si dhe të qytetarëve në luftimin e pandemisë COVID-19; 5. shfrytëzimin e objekteve dhe mjeteve të transportit; 6. mbyllja e shkollave; 7. mbyllja e aktiviteteve jopublike apo publike; 8. anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura; 9. kufizimi apo ndalimi i lëvizjeve me mjetet e transportit publik; dhe 10. kufizimi i lëvizjeve brenda vendit.*

Andaj, marrë për bazë qartësinë e përgjegjësive të një Ministri të Shëndetësisë karshi situatës konkrete të përshkruar më lart ku i njëjti përtej çdo dyshimi ka qenë i obliguar të veprojë në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së, i njëjti përmes vendimit të datës 12 gusht 2021 ka vepruar duke i neglizhuar të njëjtat e kësisoj përveç pasojave të krijuara epidemiologjike sikurse të përshkruara më lart, i njëjti me këtë veprim ka vepruar në kundërshtim me urdhrat e një organi publik kompetent në fushën e shëndetësisë siç është rasti me neglizhimin e jashtëligjshëm të rekomandimeve të IKShPK-së asisoj që ka konsumuar veprën penale *Përhapja e sëmundjeve ngjitëse* si dhe duke vepruar kësisoj i njëjti qartazi nuk i ka përpushur detyrat e tij zyrtare duke i tejkaluar kompetencat e tij e kësisoj duke konsumuar veprën penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*.

Andaj, nga sa u tha më lart, nuk ka asgjë kontestuese se z. Arben Vitia, Ministër pranë Ministrisë së Shëndetësisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes veprimeve të ndërmarra ashtu siç janë përshkruar më lart, është i përfshirë në kryerjen e veprave në kuadër të Kapitullit XXII veprën penale kundër shëndetit publik *Përhapja e sëmundjeve ngjitëse*, e përcaktuar sipas Nenit 249 si dhe në kudër të Kapitullit XXXIII të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare, përkatësisht veprën *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*, të përcaktuar sipas Nenit 414 e të gjitha të parapara sipas Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, andaj në këtë çështje kërkohet nga Prokuroria e Shtetit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme hetimore sipas autorizimeve dhe përgjegjësive të saj sipas Kodit nr. 04/1-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

---

Teutë Rrusta  
Sekretare e Përgjithshme e Partisë Social Demokrate

23 shtator 2021  
Prishtinë, Kosovë